

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-48/12

Prishtinë, 1 nëntor 2012

Në çështjen juridike të:

**Sh. K.,
A. (M.) D.
Xh. E.,
Sh. Sh. dhe
M. H.**
Prishtinë
Palët përgjegjëse/palët ankuese

kundër

M. M. P.
Beograd
Paraqitësja e kërkesës/pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga gjyqtarët: Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, Elka Filcheva-Ermenkova dhe Sylejman Nuredini, Anëtarë, duke vendosur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPPC/D/A/106/2011 (lënda është regjistruar në AKP me numrin KPA 28084), i datës 12 maj 2011, pas shqyrtimit të mbajtur me 1 nëntor të vitit 2012, mori këtë:

AKTGJYKIM

- 1- Hedhen poshtë si të palejueshme ankesat e Sh. K., A. (M.) D. dhe Xh. E., për shkak të mungesës së interesit juridik.
- 2- Pranohen ankesat e Sh. Sh, dhe M. H.
- 3- Anullohet vendimi KPPC/D/A/106/2011 (lënda është regjistruar në AKP me numrin KPA 28084 në pjesën që ka të bëjë me parcelën 1893/2), për shkak të mungesës së juridiksionit.
- 4- Hedhet kërkesa e M. M. P. Nr. KPA 28084 lidhur me parcelën 1893/2, për shkak se bie jashtë juridiksionit të KKPK-së.
- 5- Obligohet pala përgjegjëse në ankesë/paraqitësja e kërkesës që të paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej 60 € (gjashtëdhjetë euro) në Buxhetin e Kosovës brenda afatit prej 90 (nëntëdhjetë euro) ditësh, nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimi, nën kërcenimin e përmbarimit të detyrueshëm.

Historiku procedural dhe faktik:

Kërkesa:

Më 27 shkurt 2007, M. M. P. ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP) duke kërkuar kthimin në posedim të 1/3 e pjesës ideale të parcelës 1893 në Prishtinë, të përshkruar si fushë e klasës së parë me sipërfaqe 83 ari dhe 75 m². Ajo pohon që ngastra ka qenë pronë e bashkëshortit të saj të ndjerë M. P., i cili ka vdekur më 5 nëntor 1999.

Për të mbështetur kërkesën e saj ajo ka paraqitur: vendimin e marrë në procedurën e trashëgimisë nga “Gjykata e Tretë Komunale në Beograd”, të datës 19 dhjetor 2001, dosja e lëndës Nr. 2487/2001, listën poseduese Nr. 1866, e lëshuar nga Zyra Kadastrale e Prishtinës me Nr. 952-01-1/96-347, të datës 23 korrik, 1998 në emër të M. P. dhe listën poseduese nr. 1866, e lëshuar nga UNMIK-u më 28 shtator 2004 në emër të J. P., M. P. dhe M. P.

Në fletën poseduese të vitit 1998 parcela Nr. 1893 është përshkruar si fushë me sipërfaqe 1 ha dhe 32 ari dhe 5 m².

Sipas fletës poseduese të vitit 2004 parcela Nr. 1893 nuk ekziston më. Në vend të saj tri ngastra të reja përshkruhen: ngastra Nr. 1893/2 me sipërfaqe 73 ari dhe 75 m², ngastra Nr. 1893/7 me sipërfaqe 5 ari dhe ngastra Nr. 1893/8 me sipërfaqe 5 ari, dhe me gjithsej sipërfaqe 83 ari dhe 75 m² për të tri ngastrat.

Në dosjen e lëndës së AKP-së (faqe 225) është një fotografi satelitore e asaj që supozohet të ketë qenë ngastra Nr. 1893, e cila tash është ndarë në shumë ngastra të vogla – së paku 18 sosh, këto shihen në fotografi – nga Nr. 1893/1 deri te Nr. 1893/18. Nuk ka të dhëna në lëndë se kur dhe si rezultat i cilit plan kadastral ngastra nr. 1893 është ndarë në 18 ngastra të ndryshme.

Fotografia satelitore gjithashtu i paraqet edhe së paku 15 ndërtesa të ndryshme, sipas të gjitha gjasave shtëpitë janë ndërtuar brenda kufijve të ish ngastrës Nr. 1893. Nuk ka të dhëna se kur janë ndërtuar këto ndërtesa.

Në kërkesën e saj, Znj. P. ka deklaruar që toka është uzurpuar nga persona të panjohur.

AKP i ka njoftuar palët potencialisht të interesuara lidhur me procedurat duke e vendosur një njoftim informuese më 21 nëntor 2007. Njoftimi e përshkruante ngastrën në fjalë si parcela Nr. 1893. Raporti i njoftimit thoshte që toka nuk ishte e zënë dhe që nuk kishte ndërtesa në të. Më vonë, më 1 korrik 2010, AKP-ja e kishte përsërit njoftimin me publikim në gazetën e njoftimeve të AKP-së Nr. 3. Kjo do të thotë se njoftimi në vitin 2007 nuk është bërë në vendin e duhur.

Nuk ka të dhëna në dosjen e lëndës që palët e interesuara kanë shprehur interesim për t'i bashkuar procedurës para AKP-së, edhe pse siç shihej nga fotografia satelitore, prona ishte uzurpuar nga shumë njerëz të ndryshëm, të cilët i kishin ndërtuar shtëpitë e lartpërmendura. AKP-ja e shqyrtoi kërkesën si jokontestuese, por më 14 maj 2011, pas lëshimit të vendimit të ankimuar, AKP-ja ua shpërndau së paku 17 individëve të ndryshëm njoftimin mbi vendimin (faqet 129 – 144 përfshirë dosjen e lëndës së AKP-së). Vendimi i lartpërmendur, me të cilin kërkesa konsiderohej e bazuar, është marrë më 13 maj 2011, me numër KPCC/D/A/106/2011.

Me një vendim veçantë të datës 6 korrik 2011, lënda objekt i kërkesës dhe vendimi kishin veçuar 1/3 e pjesës ideale e parcelave Nr. 1893/2, 1893/7 dhe 1893/8, me sipërfaqe të përgjithshme 83 ari dhe 75 m². Nuk është e qartë se kur është ndryshuar kërkesa nga kërkesa për ngastrën Nr. 1893 në kërkesën për parcelat 1893/2, 1893/7 dhe 1893/8. Derisa paraqitësi i kërkesës, tash pala përgjegjëse në ankesë nuk është ankuar kundër vendimit dhe as që ka kërkuar që AKP-ja ta plotësojë atë, Gjykata konsideron që lënda objekt i kërkesës së specifikuar në vendimin e veçantë, e pasqyron vullnetin e paraqitësit të kërkesës.

Ankesat:

Kundër vendimit janë ankuar 5 individ të ndryshëm: Sh. K., A. (M.) D., Xh. E., Sh. Sh. dhe M. H. Të gjithë ata deklarojnë që kanë të drejtë në pjesët e parcelës Nr. 1893. Sh. K. pohon ta ketë blerë ngastrën Nr. 1893/1; A. D. ngastrën Nr. 1893/6, Xh. E. ngastrën Nr. 1893/5, Sh. Sh. 6 ari dhe 63 m² të ngastrës Nr. 1893/2 dhe M. H. 10 ari të parcelës së njëjtë Nr. 1893/2.

Sh. K. e paraqet një kontratë shitblerje të datës 28 janar 2002 të nënshkruar mes **S. K.** - babait të tij, dhe M. P. si shitës.

A. B. e paraqet një kontratë me shitësin e njëjtë të datës 15 janar 2001. Pos kësaj **A. D.** e paraqet një kontratë të lidhur mes tij në cilësinë e blerësit dhe **A. Sh.** në cilësinë e shitësit, sipas të cilës, më 4 korrik 2000, ky i fundit ia shiti një pjesë të ngastrës 1893 me sipërfaqe 15 ari (nuk është fare e qartë se si këta 15 ari janë veçuar – diferencuar nga pjesa tjetër e ngastrës). Sipas një kontrate të datës 1 qershor 1986, **A. Sh.** e bleu nga **M. P.** parcelën 1893 me sipërfaqe 30 ari.

Xh. E. e paraqet një kontratë të datës 10.10.2003.

M. P. ka vdekur më 5 nëntor 1999, në bazë të certifikatës së vdekjes.

Kontrata mund të jenë nënshkruar nga **H. H.**, të cilit **M. P.** derisa ishte gjallë ia ka dhënë autorizimin për ta shitur ngastrën Nr. 1893 – autorizimi është i datës 16 korrik 1998. Mund të përfundohet që autorizimi i dhënë është pezulluar me vdekjen e **Z. P.** – argumenti sipas nenit 94 (3) Ligji për Marrëdhëniet Detyrimore i vitit 1978, por vlefshmëria e këtyre kontratave nuk duhet të diskutohet brenda këtij vendimi, meqë ato kanë të bëjnë me ngastrat të cilat nuk ishin pjesë e lëndës objekt kontestit të vendimit të ankimuar. Vendimi nuk ka të bëjë me ngastrat Nr. 1893/1, 1893/16 dhe 1893/5, por vetëm me ngastrat nr. 1893/2, 1893/7 dhe 1893/8.

Sh. Sh. i ka blerë 6 ari dhe 63 m² nga ngastrat 1893/2 me 21 nëntor 1998 dhe **M. H.** i ka blerë 10 ari nga e njëjta parcelë më 5 tetor 1998, gjegjësisht kur **M. P.** ende ishte gjallë. Vlefshmëria e kontratave dhe e të drejtave pronësore lidhur me këto prona është shqyrtuar nga Gjykata Komunale e Prishtinës, sipas një vendimi të lëshuar nga kjo gjykatë më 8 korrik 2005, dosja e lëndës Nr. 963/2005. Gjykata e ka pranuar që **Sh.** dhe **H.** i kanë provuar të drejtat e tyre meqë e kanë blerë tokën nga **P.** Nuk është e qartë se si Gjykata e ka vlerësuar ekzistimin e pronave si pjesë të ndryshme të tokës. Parcelat janë përshkruar të jenë me sipërfaqe 6,63 ari dhe 10 ari të ngastrës Nr. 1893/2 pa asnjë karakteristikë të veçantë (si në kontratat e **Sh.** dhe **D.**, të përmendura më lart). Vlen të ceket që Gjykata në vitin 2005 është dashur të merrte në konsideratë që parcela e tokës është pronë tokësore e pandarë e formuar me kufijtë e vetë dhe pikat kufizuese, që ndodhet brenda një zone kadastrale dhe është regjistruar në Kadastër si parcelë toke me numër unik. Në mungesë të veçimit të të dy pjesëve të ndryshme – njëra me sipërfaqe 20 dhe tjetra me sipërfaqe prej 6.63 ari, të cilat janë brenda të të njëjtës parcelë Nr. 1893/2 - pa përmendur asnjë vijë/pikë kufizuese, nuk është fare e qartë se cilat ishin lëndë e së drejtës së pronësisë, ashtu siç është referuar në vendim. Në vitin 2005 legjislacioni kadastral e kishte një definicion eksplicit të asaj se ç'është një ngastër – pjesa 2, paragrafi 2.9 i Ligjit nr. 2003/25 për Kadastrën (4 dhjetor 2003), siç është ndryshuar me Ligjin nr. 02/L-96 (26 janar 2007, i zëvendësuar me Ligjin Nr. 04/-L-013 (29 korrik 2011).

Më 26 tetor 2009, paraqitësi i kërkesës, tash pala përgjegjëse në ankesë, bashkë me **M.** dhe **J. P.** e kanë parashtruar kërkesën në Gjykatë Komunale të Prishtinës kundër **H. K.**, **H. M.**, **S. T.**, **H. N.**, **M. Xh.**, **A. D.**, **S. K.**, **Sh. Y.**, **Sh. G.** dhe **T. B.** për anulimin e kontratatave të lidhura për sa i përket sipërfaqes prej 4179 m² të parcelës Nr. 1893. Nuk ka të dhëna se deri në çfarë faze të procedurës ka arritur kjo kërkesë.

Sh. Sh. dhe **M. H.** nuk janë palë përgjegjëse të kësaj kërkesë.

Përgjigja në ankesa:

Pala përgjegjëse në ankesë, paraqitësi i kërkesës në shkallën e parë konsideron që ankesa e Sh. K. është e palejueshme. Ai nuk ka qenë pala përgjegjëse në procedurën para AKP-së, prandaj ai nuk ka të drejtë ankesë. Alternativisht për sa i takon meritave të ankesës, nëse kjo shqyrtohet nga gjykata, ajo pohon se kontrata mes kësaj pale ankuese dhe bashkëshortit të saj të ndjerë është nënshkruar pas vdekjes së këtij të fundit. Ajo pohon se autorizimi i prezantuar nga pala ankuese është falsifikuar; ajo qartë i referohet autorizimit që i është dhënë H. H.

Pala përgjegjëse në ankesë nuk e shpreh mendimin për ankesat e tjera.

Më 15 qershor 2012, pala përgjegjëse në ankesë M. P., përmes Zyrës për Pronë të UNHCR-së në Beograd e ka paraqitur një letër në të cilën ajo shkruan se në vitin 1996 bashkëshorti i saj i ndjerë ia ka shitur A. Sh. 30 ari të parcelës 1893/2. Është e qartë që pala përgjegjëse në ankesë ka gabuar lidhur me vitin meqë shitblerja në fjalë daton 10 vite më herët, 1986, siç është cekur më lart.

Pala përgjegjëse në ankesë gjithashtu shpjegon se Sh. më vonë ia ka shitur ato 30 ari Sh. I., H. N., S. T., A. D. dhe M. M. Ajo në mënyrë eksplicite deklaroi se nuk e konteston të drejtën e A. Sh. për t'i shitur këto 30 ari, por ajo mbetet pranë kërkesës së saj Nr. KPA 28084, lidhur me parcelat 1893/2, 1893/7 dhe 1893/8. Është e qartë që ajo i kërkon të drejtat lidhur me pjesën e parcelës 1893/2, si tërësi me sipërfaqe 83 ari, 75 m².

Por nuk është e qartë se si kjo parcelë nr. 1893/2 është shitur në pjesë më të vogla kur parcela në fjalë në kadastër nuk figuron të jetë ndarë.

Arsyetimi ligjor:

Lidhur me pranueshmërinë e ankesave:

Ankesat janë të pranueshme. Palët ankuese nuk janë njoftuar si duhet lidhur me procedurat në AKP, prandaj e drejta e tyre për ankesë nuk është përjashtuar.

Paragrafi 10.2 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 thotë që çdo person tjetër pos paraqitësit të kërkesës, i cili pretendon të ketë të drejtë në pronën e kontestuar do të bëhet palë e procedurës me kusht që ai person ta ketë informuar Sekretariatit Ekzekutiv lidhur me synimin e tij/saj për të marrë pjesë në procedurë brenda 30 ditësh pas njoftimit për kërkesën. Me qëllim të njoftimit të AKP-së, personi në fjalë duhet të informohet lidhur me procedurën që është iniciuar. Varësisht nga ajo se ky person përgjigjet, procedura në AKP mund të zhvillohet si e jokontestimore ose mund të zhvillohet si një çështje civile-kontestuese, kurdo që të ketë palë përgjegjëse, e cila do ta kundërshtonte kërkesën e paraqitur fillimisht—argumentim sipas paragrafit 10.1 Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079.

Në procedurën kontestimore, palët duhet të kenë mundësinë të dinë dhe të komentojnë lidhur me kërkesat e parashtruara dhe dëshmitë e paraqitura nga pala tjetër. Kurdo që një personi i mohohet kjo mundësi, e drejta e tij/saj për gjykim të drejtë është cenuar.

Veçantia e procedurës në AKP është që ndryshe nga procedurat e zakonshme civile, pala përgjegjëse nuk dihet paraprakisht, por Ligji supozon që mund të ketë një/disa të atillë dhe prandaj kërkon që trupi gjykues “të bëjë përpjekje të arsyeshme për ta njoftuar çdo person tjetër, i cili mund të ketë interes juridik në pronë.”

Siç është cekur tashmë, Ligji në nenin 10.1 në vendin e njëjtë thotë që Sekretariati do të “bëjë përpjekje të arsyeshme për ta njoftuar çdo person tjetër i cili mund të ketë interes juridik në pronë”. Nuk e jep përshkrimin specifik të asaj se ç’do të thotë “përpjekje e arsyeshme” përveç “në raste të duhura, përpjekjet e atilla të arsyeshme mund të marrin formën e shpalljes në një botim zyrtar”. Interpretimi gramatikor i tekstit si edhe logjika e shëndoshë dhe zakonet ekzistuese që kanë të bëjnë me komunikimin e dokumente dhe informatave palëve në çështjet juridike kontestuese na bëjnë të vijnë në përfundim që publikimi është një përjashtim dhe do të ishte e aplikueshme vetëm në raste të veçanta, vetëm nëse është e përshtatshme – një mundësi do të ishte nëse nuk ka mjetet të tjera për ta njoftuar personin, për shembull në disa çështje civile është e pranueshme që një person të ftohet përmes publikimit në gazetën Shtetërore nëse personi e ka lënë adresën e tij/saj dhe nuk ka dhënë adresë të re. Megjithatë kjo zgjidhje do të ishte krejtësisht e papranueshme në çështjet me AKP-në, meqë pala përgjegjëse është e panjohur paraprakisht dhe në fillim të procedurës.

Deri tash është pranuar që zakonisht njoftimi është bërë me vendosjen e një njoftimi (tabele) me informacionin lidhur me kërkesën në 3 gjuhë (anglisht, shqip dhe serbisht) në pronën në fjalë dhe derisa publikimi është vendosur në vendin/objektin e duhur – parcelën, shtëpinë, etj., njoftimi konsiderohet se është bërë në mënyrë të drejtë dhe palët e mundshme të interesuara janë njoftuar me kohë për procedurën në AKP, pos nëse ka arsye të besohet ndryshe.

Në rastin aktual nuk është kontestuese që në vitin 2007 njoftimi nuk është vënë në vendin e duhur.

Pastaj, në vitin 2010, një njoftim i ri është bërë, por përmes publikimit.

Pos kësaj, në maj të vitit 2011, shumë individë të ndryshëm – së paku 17 sish (për kaq ka të dhëna në dosje), mes të cilëve edhe njëri nga ankuesit – A. D., janë njoftuar lidhur me vendimin të cilin tashmë e kishte lëshuar Komisioni për Kërkesë Pronësore i Kosovës (KPPC). Kjo do të thotë që njoftimi përmes shpalljes nuk është konsideruar si i përshtatshëm madje as nga vet zyrtarët e AKP-së – gjegjësisht, nëse shpallja do të mjaftonte, pse AKP do t’i njoftonte me vendimin këta 17 persona?

Lidhur me ankesat e Sh. K., A. D. dhe Xh. E.

Në procedurën në fjalë Sh. K., A. D. dhe M. H., përkundër ekzistimit apo mosekzistimit të ndonjë të drejte pronësore në trashëgiminë e tyre, nuk kanë interes juridik për të parashtruar ankesë ndaj vendimit të KPCC-së meqë çështja lëndore i përfshinë vetëm të drejtat lidhur me parcelat nr. 1893/2, 1893/7 dhe 1893/8. Këto tre palë ankuese kërkojnë të drejtat e tyre në parcelat 1893/1, 1893/5 dhe 1893/16. Kjo domethënë që ata nuk kanë interes juridik për ta kundërshtuar vendimin kontestues të KPCC-së dhe ekzistimi i interesit juridik është kusht paraprak absolutisht pozitiv procedural për lejueshmërinë e ankesës në procedurat civile – neni 196 në përputhshmëri me nenin 186.3 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, i

cili është i aplikueshëm për Gjykatën Supreme në procedurat ankimore kundër vendimeve të AKP-së (paragrafi 12.1 Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50).

Ligji përcakton që një ankesë është e palejueshme nëse individ i cili e ka ushtruar nuk ka interes ligjor.

Kriteri për interesin ligjor qëndron gjatë gjithë procedurës civile dhe aplikohet për secilen palë – argumentimi sipas nenit 2.4 të Ligjit të Procedurës Kontestimore. Ligji parashikon se pala duhet të ketë interes ligjor në kërkesë dhe në veprimet e tjera procedurale të cilat mund të mirren në procedurë.

Në këtë procedurë të ankimit këta ankues nuk kanë interes ligjor, prandaj kërkesat e tyre janë të palejueshme.

Lidhur me ankesat e Sh. Sh. dhe M. H.:

Ankesat janë të pranueshme dhe të lejueshme por ekziston një pengesë procedurale për zgjidhjen e tyre. Sipas paragrafit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, paraqitësi i kërkesës ka të drejtë në urdhër nga Komisioni për kthim të pronës nëse paraqitësi i kërkesës jo vetëm e dëshmon pronësinë e patundshmërisë private por gjithashtu edhe ai ose ajo nuk mund t'i ushtroje ato të drejta pronësore për arsye të rrethanave që lidhen drejtpërdrejt ose rezultojnë nga një konflikt i armatosur që ka ndodhur në Kosovë mes periudhës 27 shkurt 1998 dhe 20 qershor 1999.

Në kontekst të fakteve të vërtetuara deklarata e paraqitësit të kërkesës se ai ka humbur pronën shkaku i konflikt të viteve 1998/1999 mbetet plotësisht e pajustificuar. Nga dosja e lëndës, ashtu siç është cekur më lart është më se e qartë para së gjithash se situata kadastrale rreth parcelës në fjalë është ende e paqartë. Nuk është e qartë se kur dhe si është krijuar parcela 1893/2.

Nuk është e qartë se si në vitin 1986 z. P. e ka shitur parcelën 1893 me sipërfaqe 30 ari dhe pastaj pse kjo parcelë e njëjtë në vitin 1998 është përshkruar në listën poseduese të z. P. të jetë me sipërfaqe më të madhe se 1-ha – 1 ha e 32 ari dhe 5m². Njëjtë vlen edhe për të gjitha blerjet e pjesëve të parcelës 1893 ose të asaj 1893/2. Ajo që është e qartë nga kontrata e vitit 1986 – e Sh. është se moti para luftës pronari M. P. ka dashur ta shiste pronën e tij dhe e ka shitur (ose së paku pjesërisht), pa marrë parasysh faktin që nuk është e qartë se çfarë është shitur. Rrethanat e ngjashme vlejnë edhe për blerjet e kryera nga Sh. Sh. Dhe M. H. në vitin 1998 të sipërfaqes prej 6 ari dhe 63 m² dhe 10 ari. Përsëri, nuk ka të dhëna se çka saktësisht është shitur – këtu vlejnë argumentet se çka është një parcelë dhe si identifikohet ashtu siç është paraqitur më lart lidhur me vendimin e Gjykatës Komonale të Prishtinës të vitit 2005.

Pa marrë parasysh se çfarë ka qenë efekti juridik i këtyre blerjeve, fakti relevant në rastin aktual është se bashkëshorti i ndjerë i paraqitëses së kërkesës ka filluar ta tjetërsonte pronën e tij qysh para konflikt të armatosur dhe që nuk mund të pohohet që humbja e pronësisë ndërlihet me luftën.

Pos kësaj, në rast se tjetërsimi i lartpërmendur i pjesëve të parcelave 1893 ose 1893/2 (30 ari në vitin 1986 dhe 16 ari dhe 63 m² në vitin 1998 – gjithsej 10 ari dhe 6 ari e 63 m², nga 73 ari dhe 75 m² që është gjithsej sipërfaqja e parcelës 1893/2), kanë krijuar bartjen e të drejtave pronësore (të pjesëve ideale të parcelës 1893 ose 1893/2), bashkëpronësia është krijuar mes M. P. në njërin anë dhe blerësve në anën tjetër. Pas vdekjes së

P. kjo bashkëpronësi është transferuar në të mirë të trashëgimtarëve të tij – p.sh bashkëshortes së tij (paraqitësja e kërkesës) dhe fëmijëve të tyre dhe çështja rreth administrimit dhe/ose likudimit e kësaj bashkëpronësie duhet të përcaktohet nga gjykata e rregullt civile e Kosovës.

Në këtë drejtim Gjykata nuk duhet të shqyrtoj meritat e këtyre dy ankesave, rrespektivisht meritat e vendimit ankimor në këtë pjesë.

Shpenzimet e procedurës:

Në përputhje me Shtojcën III, nenin 8.4 të Urdhërësës Administrative (UA) 2007/5 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, palët përjashtohen prej shpenzimeve të procedurës para Sekretarisë Ekzekutive dhe Komisionit. Sidoqoftë një përjashtim i tillë nuk parashikohet në procedurën para Kolegjit të Apelit. Rrjedhimisht, regjimi normal i shpenzimeve gjyqësore siç parashihet me Ligjin mbi Taksat Gjyqësore (Gazeta Zyrtare e KSAK, 3 tetor 1987) dhe sipas UA nr. 2008/2 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës mbi Unifikimin e Taksave Gjyqësore, zbatohet ndaj procedurës së zhvilluar para Kolegjit të Apelit.

Prandaj, shpenzimet gjyqësore si në vijim aplikohen në procedurën e tanishme të ankesës:

- Taksa nga tarifa gjyqësore për paraqitjen e ankesës (neni 10.11 i UA 2008/2): 30 €
- Taksa nga tarifa gjyqësore për marrjen e aktgjykimit (nenet 10.21 dhe 10.15 të UA 2008/2), që është më së shumtë 30 €.

Këto tarifa gjyqësore duhet të merren përsipër nga pala ankuese që ka humbur rastin. Në përputhje me nenin 46 të Ligjit mbi Shpenzimet Gjyqësore, afati për pagesën e taksave në fjalë nga personi i cili ka vendqëndrim ose vendbanim jashtë vendit nuk mund të jetë më i shkurtër se 30 (tridhjetë) ditë e më i gjatë se 90 (nëntëdhjetë) ditë. Gjykata vendos që në rastin tanishëm tarifat gjyqësore duhet të paguhen nga pala ankuese brenda 90 (nëntëdhjetë). Neni 47.3 parasheh së në rast se pala nuk i paguan taksat brenda afatit të dhënë, pala duhet të paguajë një gjobë prej 50% të shumës së taksës. Nëse pala nuk i paguan taksat brenda afatit të dhënë atëherë bëhet zbatimi i detyrueshëm i pagesës.

Këshillë ligjore:

Në përputhje me Nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, EULEX

Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Elka Filcheva-Ermenkova, Gjyqtare e EULEX-it

Urs Nufer, Referent i EULEX-it